

INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS sh.p.k

NIPT: L81724027C, Adresa: Lagjia Fushe-Mezez, Rruga Industriale dytesore Tirane - Durres
Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë

VENDIM Nr.1/2022 Datë 12 Mars 2022

I Asamblesë së ortakëve të shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS”
shpk

Sot në datën 12 Mars 2022, në selinë e shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk me seli në qytetin e Tiranës në adresën Lagjia Fushë-Mëzez, Rruga Industriale dytesore Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë, u mbajt mbledhja e asamblesë në praninë e vetë ortakëve të kësaj shoqërie, z.Besim Sakajani, z.Shkëlzen Shahu, z.Stefanos Papazois, z Asterios Ntoumos të cilët përfaqësojnë 100% të kuotave të shoqërisë. Në mbledhje u konstatua se:

Ne, Ortakët e Shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ sh.p.k kemi autoritetin e kërkuar nga ligji për vlefshmërinë e mbledhjes dhe për vendim-marrje.
Ne, Ortakët me autoritetin e zotëruesve të të gjitha pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk bazuar në kompetencat që kemi në statutin e shoqërisë

Vendosëm :


- Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ shpk të auditojë pasqyrat financiare për vitin që mbyllet në 31 dhjetor 2021,
- Emërohet shoqëria ALBANIAN CONSULTANCY, me NIPT L41310001P, me auditues ligjor Z. Gentian Barjamaj, me nr. Liç.229, me NSSH H40903033G të realizojë raportin e auditimit.

Ortakët


Besim Sakajani



Shkëlzen Shahu



Stefanos Papazois



Asterios Ntoumos



BSS SH.P.K

NIPT L71910025N; Adresa: "Lagjja Fushe-Mezes", Rr. Industriale Tirane-Durres, km.1 Qendra "Pajtoni", Kati 5, Tirane Kashar

VENDIM Nr.1/2022 Datë 29 MARS 2022

I Asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë " BSS" shpk

Sot në datë 29 Mars 2022 , asambleja e ortakëve të shoqërisë "BSS" shpk, me seli në qytetin e Tiranës në adresën "Lagjja Fushë-Mëzes", Rr. Industriale Tiranë-Durrës, km.1 Qendra "Pajtoni", Kati 5, Tiranë Kashar, e përfaqësuar nga vetë ortakët, z. Shkëlzen Shahu dhe z. Besim Sakajani, të cilët përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, e mbledhur në selinë e shoqërisë, duke konstatuar se :

- a) vlefshmërinë e mbledhjes dhe vendim-marrjen për bashkimin e shoqërisë si dhe ndryshimin e statutit
- b) dhe duke marrë shkas nga vijimesia e aktivitetit të shoqërisë, shikojmë të arsyeshme që shoqëria të bashkojë aktivitetin tregëtar
- c) dhe si ortakë të shoqërisë, me autoritetin e zotëruesit të të gjitha pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë "BSS" shpk bazuar në kompetencat që kemi në statutin e shoqërisë

Vendosi :

Shoqëria "BSS" shpk të transferojë, veprimtarinë me procesin – BASHKIM ME PERTHITHJE me metoden e bashkimit të interesave, me Shoqërinë

" INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS " SH PK me NIPT L81724027C me seli në qytetin e Tiranës në adresën Tiranë Kashar MEZEZ Lagjja Fushë-Mëzez, Rruga Industriale dytësore Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë.

- Shoqëria "BSS" " shpk të quhet Shoqëri e përthithur.
- Të hartojë Projektin e bashkimit, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 " Për tregëtarët e Shoqërive tregëtare ' Neni 215 deri 225.
- Emërohet Z. Gentian Barjamaj, auditues ligjor, me nr. Liç. 229, me NSSH H40903033G, të realizojë raportin përkatës të këtij bashkimi.
- Të regjistrohet ky proces pranë Q.K.B

Asambleja e ortakëve të shoqërisë BSS shpk

Ortaku

Shkëlzen Shahu

Shkëlzen Shahu
[Signature]



Ortaku

Besim Sakajani

Besim Sakajani
[Signature]

INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS sh.p.k

NIPT: L81724027C, Adresa: Lagjia Fushe-Mezez, Rruga Industriale dytesore Tirane - Durres
Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë

VENDIM Nr.2/2022 Datë 29 Mars 2022

I Asamblesë së ortakëve të shoqërisë INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS shpk

Sot në datë 29 Mars 2022, në selinë e shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk me seli në qytetin e Tiranës në adresën Lagjia Fushë-Mëzez, Rruga Industriale dytesore Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë, u mbajt mbledhja e asamblesë në praninë e vetë ortakëve të kësaj shoqërie, z.Besim Sakajani, z.Shkëlzen Shahu, z.Stefanos Papazois, z.Asterios Ntoumos të cilët përfaqësojnë 100% të kuotave të shoqërisë. Në mbledhje u konstatua se:

Ne, Ortaket e Shoqërisë “ INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS “ shpk kemi autoritetin e kërkuar nga ligji për vlefshmërinë e mbledhjes dhe vendim-marrjes për bashkimin e shoqërisë si dhe ndryshimin e statutit.

Dhe duke marrë shkas nga vijimësia e aktivitetit të shoqërisë, Ortakët e kësaj Shoqërie shohin të arsyeshme që shoqëria të bashkojë aktivitetin tregëtar.

Ne, Ortakët me autoritetin e zotëruesit të të gjitha pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk bazuar në kompetencat që kemi në statutin e shoqërisë

Vendosëm:

Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ shpk të bashkojë veprimtarinë e saj, me procesin – BASHKIM ME PERTHITHJE me metodën e bashkimit të interesave, me Shoqërinë.

“BSS“ SHPK me NIPT L71910025N, me seli në qytetin e Tiranës në adresën Lagjia Fushë-Mëzez, Rruga Industriale dytesore Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë,.

- Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS “ shpk të quhet Shoqëri përthithëse në këtë proces bashkimi.
- Të hartojë Projektin e bashkimit, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët e Shoqërisë tregëtare ‘ Neni 215 deri 225.
- Emërohet Z. Gentian Barjamaj, auditues ligjor, me nr. Liç.229, me NSSH H40903033G të realizojë procesin e këtij bashkimi.
- Të regjistrohet ky proces pranë QKB.

Ortakët:

Besim Sakajani Shkëlzen Shahu Stefanos Papazois Asterios Ntoumos
Besim Sakajani *Shkëlzen Shahu* *Stefanos Papazois* *Asterios Ntoumos*




RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PËR VLERËSIMIN E KUSHTEVE TË PROJEKT- MARRËVESHJES

SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE

“INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SH.P.K

DHE

“BSS” SH.P.K

TIRANË MË 29/03/2022

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'G. Hoxha', with a date '29/03' written below it.



Albanian Consultancy

PËR ASAMBLENË E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
“INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SH.P.K

Të nderuar

Në cilësinë e Audituesit Ligjor, i emëruar nga Ju, në vendimet e asambleve, respektivisht të asamblesë të shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SH.P.K me nr. vendimi 2/2022 datë 29.03.2022 dhe të shoqërisë “BSS” SH.P.K me nr. vendimi 1/2022 datë 29.03.2022, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 216 pika 1,2,3,4 dhe neni 2018 pika 1,2,3 kam pranuar misionin për vlerësimin e kushteve të project marrëveshjes dhe vlerësimin e kapitaleve nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë BSS(shoqëria e përthithur) nga shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” (shoqëria përthithëse), ju paraqes raportin si vijon:

Për vlerësimin e kushteve të project-marrëveshjes dhe vlerësimin e kapitaleve për bashkimin nëpërmjet përthithjes të të shoqërisë BSS(shoqëria A, e përthithur) nga shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” (shoqëria B, përthithëse), jam mbështetur në dokumentacionin përkatës të bashkimit me përthithje të tilla si: vendimet e asambleve për miratimin e bashkimit, project-marrëveshja, bilancet e viteve të fundit të shoqërive.

1. Të dhëna mbi shoqëritë që marrin pjesë në bashkim.

A. – Shoqëria që quhet Përthithëse :

Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me këto të dhëna;

- numër unik të identifikimit të subjektit NIPT L81724027C,
- seli- Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiran,



Russell Bedford
taking you further

Albanian Consultancy
Member of Russell Bedford International- a global network of independent professional services firms
Rr. “Sami Frashëri”, P. Titan Konstruksion, K. 10, Nr.34-Tiranë - T: +355 4 450 3233

Faqe 1 / 4



Albanian Consultancy

- e përfaqësuar nga administratori i saj z. Besim Sakajani
- kapitali: 100 000 (njëqind mijë) lekë,
- në përqindje 100 % (njëqind për qind)
- numri i koutave: 4 (katër) kuota, zotëruar si vijon:
- një kuotë, 40%(dyzet%), vlera nominale 40 000 (dyzet) mijë zotëruar nga z. Shkelzen Shahu.
- një kuotë, 10%(dhjetë%), vlera nominale 10000(dhjetë)mijë zotëruar nga z. Stefanos Papazios
- një kuotë, 10%(dhjetë%), vlera nominale 10000(dhjetë)mijë zotëruar nga z. Asterios Ntoumos
- një kuotë, 40% (dyzet %), vlera nominale 40 000 (dyzet)mijë zotëruar nga z. Besim Sakajani

B – Shoqëria që quhet e Përthithur:

Shoqëria “BSS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, e regjistruar në QKB me këto të dhëna;

- numër unik i identifikimit të subjektit NIPT L71910025N,
- seli- Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë,
- e përfaqësuar nga administratori i saj z. Besim Sakajani.
- kapitali: 100 000 (njëqind mijë) lekë,
- numri i kuotave: 2 (dy),
- në përqindje 100 % (njëqind për qind)
- 1(një) kuotë, 50%, vlera nominale 50 000(pesëdhjetë mijë) zotëruar nga z. Shkelzen Shahu.
- 1(një) kuotë, 50%, vlera nominale 50 000(pesëdhjetë mijë) zotëruar nga z. Besim Sakajani.

2. Kapitali rezulton i paguar në masën 100 000(njëqindmijë) lekë për secilën shoqëri
3. Baza ligjore dhe dokumentacioni mbi të cilin mbështetet ky bashkim është si më poshtë:
 - a) Projekt-marrëveshje për bashkimin më përthithje e datës 29.03.2022
 - b) Raportet e administratorëve për bashkimin me përthithje
 - c) Vendimet e asambleve respektive
 - d) Bilancet kontabël-pasqyrat financiare të vitit 2021, të hartuara sipas ligjit 25/2018
 - e) Ligji nr.9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
 - f) Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKB”,
 - g) Ligji 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
4. Për kapitalin dhe elementet e tjerë të pasurisë
 - a) Elementët e pasurisë





Albanian Consultancy

Nga ana ime u morën në analizë dhe u verifikuan e kontrolluan të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me pasurinë e ndërmarrjeve para përthithjes si dhe u rivendosën, u klasifikuan dhe u pozicionuan në postet përkatëse të gjitha të dhënat e pasurisë së krijuar. Për këtë vlerësim, janë mbajtur parasysh të gjitha kriteret ligjore dhe kontabël, regjistrimet e deklaruara pranë QKB, të cilat përfshijnë pasqyrat financiare të viteve të fundit, vendime asambleje për çështje të ndryshme, deklarime të dhëna vullnetarisht të cilat kanë lidhje me objektin e aktivitetit, adresa dytësore, shtesa të tjera të ndryshme, ndryshime vlerash në kontribute dhe/ose ndryshim ortakësh etj.

b) Për kapitalin e nënshkruar

Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk ka një kapital të nënshkruar dhe të paguar prej 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në tre kuota dhe është në pronësi shqiptare dhe të huaj.

Shoqëria “BSS” shpk ka një kapital të nënshkruar e të paguar prej 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i shoqërisë është i ndatë në dy kuota dhe është në pronësi shqiptare.

Të dyja shoqëritë e kanë të vërtetuar këtë shumë kapitali nga pasqyrat financiare të deklaruara gjatë periudhave si dhe nga regjistrimet në regjistrin kombëtar të biznesit QKB.

Transferimi i kapitalit do të bëhet duke mos ndryshuar kuotat dhe përqindjen që zotërojnë ortakët në shoqërinë përthithëse.

Të dhënat respektive të shoqërive që janë pjesë e procesit të përthithjes jepen mw poshtw nw tabelw

Shoqëria/Periudha	IPS 2021	BSS 2021	IPS + BSS 2021
Totali i aktiveve afatshkurtra	77,550,010	9,913,576	87,463,586
Aktive materiale	10,594,721	7,320,519	17,915,240
TOTALI I AKTIVEVE	88,144,731	17,234,095	105,378,826
			0
Totali i detyrimeve afatshkurta	21,520,424	19,108,869	40,629,293
Totali i detyrimeve afatgjata	0	0	0
Detyrime totale	21,520,424	19,108,869	40,629,293
Kapitali i nënshkruar	100,000	100,000	200,000
Rezerva të tjera	0	1,386,562	1,386,562
Fitimi/(humbja) e periudhes	66,624,207	-3,361,336	63,262,871
TOTALI I DETY. DHE KAPITALIT	88,144,731	17,234,095	105,378,826



Albanian Consultancy

5. Regjistrime te shoqëria përthithëse

Data e regjistrimit të ndryshimeve do të jetë data kur këto ndryshime do të rregjistrohen nga QKB njëhohësisht shoqëria përthithëse do të pasqyrojë gjendjet e reja të krijuara nga përthithja si dhe shoqëria e përthithur do të rezultojë si e mbyllur. Të gjitha efektet e krijuara në shoqërinë e përthithur do të jenë pjesë përbërëse e shoqërisë përthithëse që nga ky moment. Të gjitha veprimet, detyrimet, të drejtat, që nga data e caktuar si fillimi i procesit të përthithjes dhe deri në çastin e regjistrimit në regjistrat e QKB, do të regjistrohen në retrospektivë në shoqërinë përthithëse.

Pas analizimit të të gjithë dokumentacionit, të pozicionit të llogarive si dhe paraqitjes dhe pozicionit të tyre në raport me aktet ligjore dhe kontabël, arrita në përfundimin se:

Projekti I marveshjes për përthithjen e shoqërisë BSS sh.p.k nga shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” sh.p.k, është i mundur, i mbështetur në aktet ligjore e nënligjore, bashkimi i këtyre shoqërive nuk cënon të drejtat dhe detyrimet e asnjë pale në këtë proces, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së përthithur pasqyrohen saktë dhe drejtë në regjistrat e shoqërisë përthithëse, vlerat e pasurisë pasqyrohen saktë dhe kapitali i shoqërisë është reflektuar drejt duke dhënë një shumë të kapitalit të të dy shoqërive para përthithjes por pa ndryshuar kuotat e pjesëmarrjes dhe përqindjet përkatëse të ortakëve të shoqërisë përthithëse. Kuota dhe ortakë pakicë nuk janë krijuar.

Sipas opinionit tim, janë zbatuar të gjitha kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe kërkesat e ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKB”

Për ALBANIAN CONSULTANCY
Gentian Barjamaj-Auditues Ligjor-Liç.Nr.229
Rruga “Sami Frashëri” P.Titan,
K. 10, Nr. 34 – Tiranë

29 Mars 2022



Russell Bedford
taking you further

Albanian Consultancy
Member of Russell Bedford International - a global network of independent professional services firms
Rr. "Sami Frashëri", P. Titan Konstruksion, K. 10, Nr.34-Tiranë - T: +355 4 450 3233